



Planuar / Ditezuar Planned/Produato Planned/Produato	26.06	3	viti god year
Organ/Rjesa Organ/Rjesa Org./Bior.	Nr. Prot. Nr. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicema Quantity
SANKC	4917/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.732/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1112/21 të datës 01.06.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.732/2019 të datës 22.11.2019 të parashtruar nga ankuesi [Blank], me adresë rruga [Blank], kundër Vendimit me Nr. 784 të datës 10.09.2019 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, në çështjen juridike "pezullim parandalues", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i inicuar sipas ankesës me numër A.nr.732/2019 e datës 22.11.2019 e parashtruar nga ankuesi [Blank]

A r s y e t i m

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Kosovës më datë 09.09.2019, ka kërkuar nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa/Sektori i Tatimit në Pronë i Komunës së Gjilanit të sigurojë vërtetimet e lëshuara të tatimit në pronë pasi që rasti është duke u hetuar sipas Autorizimit të PTHPSË Gjilan me nr. ppn.i.NR.98/2019 nën dyshimin e veprës penale për "Keqpërdorim të Pozitës apo Autoritetit Zyrtar".

Kryetari i Komunës së Gjilanit pas kësaj shkresë më datë 10.09.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 784 për "pezullim parandalues" më 50% të pagës për ankuesin deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

Ankuesi kundër këtij vendimi, më datë 08.10.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjilanit. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit, më datë 28.10.2019 ka njoftuar ankuesin se Komisioni për Ankesa nuk ekziston më pasi që ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe ankesë mund të parashtrohet drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kryetari i Komunës së Gjilanit më datë 10.09.2019 dhe 22.10.2019 ka kërkuar nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan të njoftohet se a është iniciuar ndonjë procedurë penale ndaj ankuesit.

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan më datë 22.10.2019 ka njoftuar Kryetarin e Komunës së Gjilanit se: *“Prokuroria Themelore në Gjilan, ju njofton se në regjistrat e Departamentit të Përgjithshëm dhe të Departamentit të Krimeve të Rënda, personi në fjalë ka këto lëndë: në Departamentin për Krime të Rënda, lënda me nr. PP/I.nr.156/2019,. Vepra penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare nga neni 414 të KPPK-së, lënda gjendet në procedurë. Në Departamentin e Përgjithshëm, lënda me nr. PP/II.nr.893/2009, vepra penale Lëndim i lehtë truporë nga neni 153 të KPK-së, është ndritur Aktakuzë me urdhër ndëshkimor më datë 03.06.2009”.*

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr. 784 të datës 10.09.2019 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit për pezullim parandalues, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.11.2019 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5499/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 27.11.2019 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Komuna e Gjilanit. Me datë 09.12.2019 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Gjilanit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli, në mungesë të kuorumit për vendosje, më datë 17.12.2019 ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, ndërsa ankuesi ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 01.06.2023 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.112/21 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesa me numër protokollit 5499/2019 të datës 22.11.2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Ankesën e datës 08.10.2019 të parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjilanit; Njoftimin e datës 29.10.2019 nga Kryesuesi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave për ankuesin; Kërkesën e datës 09.09.2019 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës; Flete dorëzimi i datës 10.09.2019; Vendimin me Nr. 784 të datës 10.09.2019 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit për pezullim parandalues të ankuesit; Letër përcjellëse e datës 11.09.2019; Kërkesën e datës 10.09.2019 dhe 22.10.2019 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit për Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Gjilan; Njoftimin e datës 23.10.2019 nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan për Kryetarin e Komunës së Gjilanit; Përgjigjen në ankesë nga Komuna e Gjilanit me numër protokollit 5703/2019 të datës 09.12.2019; Njoftimin e datës 17.12.2019; Aktvendimin C.nr.82.20 të Gjykatës Themelore në Gjilan; Përgjigje në padi e datës 15.05.2020; Aktvendimin C.nr.82.2020 i datës 26.03.2021 i Gjykatës Themelore në Gjilan; Aktgjykimin A.nr.1112/21 të datës 01.06.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Vendimin A.nr.934/2022 i datës 19.12.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, konstatoi që të përfundohet procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.732/2019 të datës 22.11.2019 të ankuesit, *sepse*:

Lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës dhe në bazë të shqyrtimit të tyre ka konstatuar se lidhur me rastin e ankuesit për të cilin është nxjerr vendimi i kontestuar me këtë ankesë respektivisht Vendimi me Nr. 784 i datës 10.09.2019 i Kryetarit të Komunës së Gjilanit për pezullim parandalues, Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda më datë 01.12.2021 ka nxjerr Aktgjykim PKR.Nr.185/2019 përmes të cilit ankuesi është shpall fajtor për veprën penale "Falsifikimin e Dokumenteve Zyrtare" duke e dënuar me burgim në kohëzgjatje prej njëqind tetëdhjetë (180) ditë i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej pesë mijë (5000) euro, dhe dënim plotësues Ndalim i Ushtrimit të Funkcioneve në Administratën Publike ose në Shërbimin Publikë prej dy (2) vite pas plotfuqishmërisë së Aktgjyimit.

Kryetari i Komunës së Gjilanit duke marr parasysh që Aktgjykimi i lartcekur është bërë i plotfuqishëm më datë 21.02.2022, më datë 23.09.2022 ka nxjerr Vendim me numër protokollit 02/987, përmes të cilit ankuesit i përfundon marrëdhënia e punës në shërbimin civil dhe njëherë ka shfuqizuar Vendimin me Nr. 784 të datës 10.09.2019 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit.

Ankuesi kundër Vendimit me numër protokollit 02/987 të datës 23.09.2022 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, më datë 20.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 19.12.2022 ka nxjerr Vendim A.nr.934/2022 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi Vendimin me numër protokollit 02/987 të datës 23.09.2022 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit.

Duke marr parasysh faktin se ankuesit përmes Vendimit me numër protokolli 02/987 të datës 23.09.2022 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit i është përfunduar marrëdhënia e punës dhe është shfuqizuar Vendimi me Nr. 784 i datës 10.09.2019 i Kryetarit të Komunës së Gjilanit, atëherë sipas Kolegjit të Këshillit, objekti për të cilin ka filluar procedimin administrativ me ankesën e ankuesit të datës 22.11.2019 kundër Vendimit me Nr. 784 të datës 10.09.2019 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, është bërë i pamundur apo i kotë për shkak që ky vendim është i shfuqizuar, kështu që marr parasysh të gjitha rrethanat e rastit Kolegji i Këshillit në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*, konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me ankesën me numër A.nr.732/2019 e datës 22.11.2019 e parashtruar nga ankuesi.

Theksuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.732/2019.

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.